



Pranim / Dorezuar Prilimeno/Preclato Received/Delivered	23.06.2021	1	viti qoft year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prclt Br Prclt Prct No	Shtypja Printog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTOL	3277/2021		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.493/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malësore Gashi-Bajraktari, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin numër A.nr.2119/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 31.02.2021, ka shqyrtuar ankesën A.nr.399/2019, të datës 15.07.2019, të ankuesit me adresë banimi: Rruga “Lekë Dukagjini” Nr.37, Komuna e Gjilanit, kundër Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 23.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZHET si e pabazuar** ankesa me numër A.nr. 399/2019 e datës 15.07.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi** Vendimi numër 02Nr.016-60602/1 i datës 21.06.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit.

A r s y e t i m

Komuna e Gjilanit në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrit të Administratës Publike të datës 04.03.2019, me datë 06.03.2019 ka shpallur konkursin për pozitën “Zyrtar i Depos 3”, të cilin konkurs përmes njoftimit të datës 23.03.2019 e ka vazhduar edhe për shtatë (7) ditë kalendarike. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë) por që nuk është përzgjedhur si kandidat i suksesshëm në këtë pozitë.

Komuna e Gjilanit më datë 21.05.2019 ka publikuar njoftimin me numër 02 Nr. 016/56093 për kandidatin e suksesshëm, ndërsa ankuesi kundër këtij njoftimi më datë 31.05.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit.



" Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit më datë 21.06.2019 nxjerr Vendim me numër 02Nr.016-60602/1 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses duke lënë në fuqi shpalljen e publikimit të rezultateve

Ankuesja kundër Vendimit me numër 02Nr.016-60602/1 të datës 21.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.07.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3148/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 02.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 31.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2119/2019 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.06.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 15.07.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 29.07.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Gjilanit, ndërsa me datën 15.08.2019 me numër protokollit 3306/2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë Komuna e Gjilanit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3148/2019 e datës 15.07.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me 02Nr.016-60602/1 i datës 21.06.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit; Vendimi për anulimin e konkursit i datës 11.01.2019; Lista e kandidatëve për asamble komunale të komunës së Gjilanit; Konkursi i datës 06.03.2019, Formulari Form. MAP/SHCK-09 për Përmbledhjen e Vlerësimeve Individuale; Vendimi për aprovimin e raportit final i datës 20.05.2019; autorizimi i lëshuar nga DASHC/MAP i datës 04.03.2019; Njoftimi për zgjatjen e afatit për pranimin e aplikacioneve; Vendimi për themelimin e komisionit përzgjedhës i datës 20.03.2019; Formulari për kërkesë apo i ankesë i datës 13.03.2019; Formulari i Aplikimit i datës 13.03.2019; Letërnjoftimi i kandidatit të përzgjedhur; Diploma e datës 19.06.1986 me numër 073021; Vërtetimi i datës 12.12.2018; Çertifikata e datës 13.12.2019 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan; Letër reference e datës 03.12.2019; kërkesa për punësim e datës 19.03.2019, letërnjoftimi i ankuesit; Diploma e datës 04.05.2018 me numër Nr.476/18; Diploma e datës 13.06.2003 me numër Nr.073022/1; Çertifikata e datës 18.11.2018 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan; Çertifikata e datës 10.12.2006; Vërtetimi i datës 04.04.2019 me Nr.345/2019; Çertifikata e datës 21.01.2010; referencë e datës 07.11.2018; Çertifikata e datës 15.10.2010; vërtetim i datës 28.07.2008; Formulari Form.MAP-SHCK-08a për Vlerësimin individuale i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formulari Form.MAP-SHCK-04 për regjistrin e Aplikacioneve të pranuar; Formulari Form.MAP-SHCK-05 përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e shkurtë; Raporti për përpilimin e listës së shkurtë datës 04.04.2019; Njoftimi i mbajtjes së datës me shkrim; Testi me shkrim i kandidatit të përzgjedhur i datës 10.04.2019; Testi me shkrim i ankuesit i datës 10.04.2019;

Raporti i datës 24.04.2019 për vlerësimi nga testi i mbajtur me shkrim për pozitën “Zyrtar i Depos 3”; Njoftimi për mbajtjen e intervistës me gojë; Formulari Form MAP-SHCK-09 për Përmbledhjen Individuale të vlerësimeve; Formulari Form MAP-SHCK-10 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formulari Form.MAP-SHCK-11 i Raportit Final të Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues; vendimi kryetarit të komunës i datës 14.05.2019 me numër Prot: 02 Nr.353; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 20.05.2019; Ankesa e ankuesit e parashtrua në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e datës 31.05.2019; Ftesa për Seancë dëgjimore e datës 12.06.2019 e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Procesverbali i datës 17.06.2019; Procesverbali për konsultim dhe votim i datës 17.06.2019; Vendimi me 02Nr.016-60602/1 i datës 21.06.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 29.07.2019; Përgjigja në kërkesë e datës 15.08.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që: seanca dëgjimore e organizuar nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe ankesave i Komunës së Gjilanit është mbajtur në kundërshtim dispozitat e Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave si dhe kandidati i përzgjedhur nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara sipas konkursit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimore të ankuesit i cili pretendon që seanca dëgjimore e organizuar nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit është mbajtur në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.05/2011 për procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, ka konstatuar se ankuesi e ka parashtruar ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 31.05.2019 ndërsa në bazë të fletëthirrjes me numër 02 Nr.016-65310 të datës 12.06.2019 ankuesi është ftuar të marrë pjesë në seancën dëgjimore e paraparë të mbahet me datë 17.06.2019 në Zyrën e Njësisë së Personelit, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit vendimin i cili është objekt shqyrtimi në këtë lëndë e ka nxjerrë me datë 21.06.2019 dhe numër protokoll:02/016-60602/1, andaj me këtë rast Kolegji konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka vepruar në pajtim Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave neni 9 paragrafi 7 i cili përcakton se: *“Komisioni duhet ta marrë vendim brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të ankesës”*, andaj mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se në bazë të autorizimit të lëshuar nga DASHC/MAP me datë 04.03.2019 si dhe në bazë të konkursit të datës 06.03.2019 kriteret e konkursit kanë qenë: *“Arsimim i mesëm, trajnim përkatës dhe së paku tre (3) vite përvojë punë në fushën përkatëse teknike”* ndërsa në dosjen e kandidatit të përzgjedhur e cila është dërguar së bashku me dokumentet e tjera të procedurës rekrutuese nga komuna e Gjilanit me datë 15.08.2019, është vërtetuar se kandidati i përzgjedhur posedon Diplomën e datës 19.06.1986 me të cilën dëshmohet se i njëjti ka përfunduar Shkollën e Mesme Profesionale–Teknike dhe ka marrë titullin „Elektroteknik i Automatikes” si dhe në bazë të vërtetimit të datës 12.12.2018 të lëshuar nga N.T.SH „Tecno Ceramika” me të cilën dëshmohet se i njëjti ka punuar prej datës 01.08.2012-vazhdon në pozitën „Udhëheqës i Punëve Administrative”, andaj me rastin e përfshirjes në listën e ngushtë të kandidatit të përzgjedhur Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 28 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili përcakton se: *“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim: arsimim dhe kualifikim profesional dhe përvoja e punës”*, si rrjedhojë mbi këtë bazë me rastin e përzgjedhjes së tij Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat ligjore Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18 paragrafi 1 i cili përcakton që *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe*



paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidateve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës”, sepse kandidati i përzgjedhur i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në konkurs dhe në këtë kuptim pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar Raportin për Renditjen Përfundimtare të Kandidatëve (Form.MAP-SHCK-10) ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur ka grumbulluar gjithsejtë 74.5 pikë dhe është renditur i pari, ndërsa ankuesi ka grumbulluar gjithsejtë 70.5 pikë dhe është renditur i dyti, ndërsa me më Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 40 paragrafi 1 përcakton se: “Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testin me shkrim dhe me gojë” andaj me këtë rast Komisioni Përzgjedhës me rastin e rekomandimit të kandidatit të përzgjedhur për emërim në shërbimin civil ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 11 paragrafi 1 i cili përcakton që “Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Gjilanit, me rastin e nxjertjes së Vendimit me 02Nr.016-60602/1 të datës 21.06.2019 ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, pasi që ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.493/2021**

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit
- Arkivit të KPMSHCK-se